

Organizata për siguri dhe bashkëpunim në Evropë
MISIONI NË KOSOVË

Raporti 03/2009 i Misionit të OSBE-së në Kosovë
Mbi monitorimin e Kuvendit të Kosovës
1 maj 2009 – 30 qershor 2009

Titujt kryesor

- Kuvendi zgjedh Avokatin e Popullit
- Kuvendi miraton gjashtë gjyqtarë të gjykatës kushtetuese
- Kuvendi emëron zëvendës kryeministrin Hajredin Kuçi kryesues të komisionit *ad hoc* për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të bordit të Radio Televizionit të Kosovës
- Kuvendi has vështirësi në mbajtjen e seancave plenare
- Kuvendi vazhdon të ketë vështirësi në menagjimin e kohës për pyetjet parlamentare
- Grupi parlamentar “Zajedno” pushon së ekzistuari

1. Sfond

Raporti i gjashtëdhjetetretë i monitorimit është hartuar në përputhje me pikëpamjet referuese të Shtyllës së tretë të UNMIK-ut për themelimin e institucioneve (OSBE) dhe monitorimin e Kuvendit të Kosovës prej datës 26 nëntor 2002 dhe bazohet në Rregulloren e re të punës, të miratuar në fund të seancës plenare më 20 maj 2005 dhe të reviduar në seancën plenare të mbajtur më 1-2 qershor 2006 dhe 18 shtator 2007.

Misioni i OSBE-së në Kosovë ka monitoruar nëntë seanca plenare të rregullta, më 14-22-27-28 maj¹, më 15 maj, më 28 maj, më 29 maj, më 4 qershor, më 11-18 qershor, më 12 qershor, më 23 qershor dhe më 25 qershor, si dhe shtatë mbledhje të Kryesisë, më 5 maj, më 13 maj, më 19 maj, më 26 maj, më 2 qershor, më 9 qershor dhe më 16 qershor. Misioni i OSBE-së në Kosovë ka monitoruar 41 nga 59 mbledhje të komisioneve.

2. Vështrim

Seancën plenare të Kuvendit të Kosovës të mbajtur më 14-15-22-27-28 maj e kryesoi Kryetari i Kuvendit z. Jakup Krasniqi (Partia Demokratike e Kosovës - PDK) dhe anëtari i Kryesisë z. Ibrahim Gashi – AKR).

- Shtatëdhjetë deputetë ishin të pranishëm në seancën plenare më më 14-15 -22-27-28 maj.²
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës së plenare të mbajtur më më 14-15-22-27-28 maj:
 - Pyetjet për Qeverinë pë përgjigje me gojë
 - Shqyrtimi i parë i projektligjit për standardizimin (Projektligji është miratuar në parim me 60 vota për dhe pa vota kundër.)
 - Shqyrtimi i parë i projektligjit për pjesëmarrjen dhe fuqizimin e rinisë (Projektligji është miratuar në parim me 61 vota për dhe pa vota kundër.)
 - Shqyrtimi i parë i projektligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar (Projektligji është miratuar në parim me 49 vota për dhe 11 vota kundër.)
 - Shqyrtimi i parë i projektligjit për produktet biocide

¹ Seanca plenare e filluar më 14 maj, është ndërprerë dhe vazhduar disa herë.

² Ky është numri i deputetëve të pranishëm i lajmëruar nga Kryetari i Kuvendit në fillim të seancës plenare.

- (Projektligji është miratuar në parim me 75 vota për dhe pa vota kundër.)
- Shqyrtimi i raportit të komisionit të pavarur për miniera dhe minerale për vitin 2008 (Raporti është miratuar me 42 vota për dhe tetë vota kundër.)
- Shqyrtimi i raportit vjetor 2008 të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (Raporti është miratuar me 41 vota për dhe njëmbëdhjetë vota kundër.)
- Shqyrtimi i raportit vjetor 2008 i Agjensionit Kosovar kundër Korrupsionit (Raporti është miratuar me 60 vota për dhe pa vota kundër.)
- Themelimi i komisionit *ad hoc* për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të bordit të RTK-së (Komisioni *ad hoc* është themeluar me 56 vota për, 28 vota kundër dhe pesë abstenime. Shiko më poshtë pjesën e titulluar “Kuvendi emëron zëvendës kryeministrin Hajredin Kuçi kryesues të komisionit *ad hoc* për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të bordit të Radio Televizionit të Kosovës”.)
- Informacion lidhur me gjendjen në trustin pensional të Kosovës (Guvernatori i Bankës Qendrore Hashim Rexhepi paraqiti informacionin i cili u pasua me debat të gjërë plenar.)

Seancën plenare të mbajtur më 15 maj e kryesoi Kryetari i Kuvendit z. Jakup Krasniqi (PDK) dhe anëtari i Kryesisë z. Ibrahim Gashi (AKR).

- Nëntëdhjetë e nëntë deputetë ishin të pranishëm në seancën plenare më 15 maj.
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare të mbajtur më 15 maj:
 - Shqyrtimi i propozimit për miratimin e gjykatësve të Gjykatës Kushtetuese (Kuvendi ka miratuar gjashtë gjykatës të Gjykatës Kushtetuese. Shiko më poshtë pjesën e titulluar “Kuvendi miraton gjashtë gjykatës të Gjykatës Kushtetuese”.)

Seancën solemne plenare të mbajtur më 21 maj e kryesoi Kryetari i Kuvendit z. Jakup Krasniqi (PDK).

- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës solemne plenare të mbajtur më 21 maj:
 - Fjala e zëvendës kryetarit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës z. Joseph Biden

Seancën plenare të mbajtur më 28 maj e kryesuan anëtarët e Kryesisë së Kuvendit z. Xhavit Haliti (PDK) dhe z. Eqrem kryeziu (LDK).

- Nëntëdhjetë e një deputetë ishin të pranishëm në seancën plenare më 28 maj.
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare të mbajtur më 28 maj:
 - Pyetjet për Qeverinë për përgjigje me gojë
 - Shqyrtimi i raportit të Rregullatorit për Ujë dhe Mbeturina (Raporti është miratuar me 81 vota për dhe pa vota kundër.)
 - Debati për privatizimin, i kërkuar nga një grup deputetësh (Debati është hapur nga z. Arsim Rexhepi (LDK) i pasuar nga debat i gjërë plenar dhe është përmbyllur nga z. Rexhepi.)
 - Shqyrtimi i parë i projektligjit për anëtarësimin e Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe organizatën e Grupit të Bankës Botërore (Projektligji është miratuar në parim me 79 vota për dhe pa vota kundër.)

Seancën plenare të mbajtur më 29 maj e kryesoi Kryetari i Kuvendit Jakup Krasniqi (PDK) dhe anëtari i Kryesisë së Kuvendit z. Xhavit Haliti (PDK).

- Gjashtëdhjetë e tetë deputetë ishin të pranishëm në seancën plenare më 29 maj.
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare të mbajtur më 29 maj:

- Shqyrtimi i dytë i projektligjit për anëtarësimin e Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe organizatën e Grupit të Bankës Botërore (Projektligji është miratuar me 81 vota për dhe pa vota kundër.)

Seancën plenare të mbajtur më 4 qershor e kryesoi Kryetari i Kuvendit Jakup Krasniqi (PDK) dhe anëtari i Kryesisë z. Sabri Hamiti (LDK).

- Njëqind e një deputetë ishin të pranishëm në seancën plenare më 4 qershor.
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare të mbajtur më 4 qershor:
 - Zgjedhja e Avokatit të Popullit (Avokati i Popullit është zgjedhur me 65 vota për. Shiko më poshtë pjesën e titulluar “Kuvendi zgjedh Avokatin e Popullit.”)

Seancën plenare të mbajtur më 11 – 18 qershor e kryesoi Kryetari i Kuvendit Jakup Krasniqi (PDK) dhe anëtari i Kryesisë z. Naim Maloku (AAK).

- Tetëdhjetë e një deputetë ishin të pranishëm në seancën plenare më 11-18 qershor.
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare të mbajtur më 11–18 qershor:
 - Pyetjet për Qeverinë për përgjigje me gojë
 - Shqyrtimi i parë i projektligjit për ndryshimin e ligjit Nr. 2003/15 për skemën sociale në Kosovë (Shqyrtimi i parë i projektligjit në fjalë është shtyrë me kërkesë të Ministrit për punë dhe mirëqenie sociale Nenad Rasić)
 - Shqyrtimi i parë i projektligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publik (Projektligji është miratuar në parim me 64 vota për dhe dy vota kundër.)
 - Shqyrtimi i parë i projektligjit për ndryshimin e ligjit Nr. 02/L-133 për parandalimin e konfliktit të interesit gjatë ushtrimit të funksionit publik (Projektligji është miratuar në parim me 57 vota për dhe pa vota kundër.)
 - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për bujqësinë dhe zhvillimin rural (Projektligji është miratuar me 59 vota për dhe një votë kundër.)
 - Shqyrtimi i rregullores së punës (Shqyrtimi i rregullores së punës është hequr nga rendi i ditës me 56 vota për dhe 20 vota kundër me kërkesë të shefit të grupit parlamentar të PDK-së z. Ramë Buja.)
 - Shqyrtimi i raportit të Radio televizionit të Kosovës për vitin 2008 (Kjo pikë është hequr nga rendi i ditës me kërkesë të z. Esat Brajshori (AKR), kryesues i komisionit për shërbime publike, administratë lokale dhe media.)
 - Shqyrtimi i raportit të komisionit për legjislacion dhe gjyqësi lidhur me themelimin e komisionit për provimin e judikaturës (Raporti i komisionit për legjislacion dhe gjyqësi është miratuar me 40 vota për dhe 13 vota kundër.)
 - Shqyrtimi i propozim vendimit të Qeverisë i kornizës afatmesme të shpenzimeve 2010-2012 (Shqyrtimi i kornizës afatmesme të shpenzimeve ka përfunduar pa votim meqë do të votohet së bashku me buxhetin për vitin 2010.)
 - Shqyrtimi i raportit vjetor 2008 mbi funksionimin e sistemit të brendshëm të auditimit në sektorin publik të Kosovës (Raporti vjetor është miratuar me 61 vota për dhe dy vota kundër.)
 - Shqyrtimi i raportit vjetor 2008 të autoritetit rregullator të telekomunikacionit (Raporti është shqyrtuar dhe rekomandimet e komisionit funksional në këtë raport janë miratuar.)
 - Shqyrtimi i propozim vendimit të Qeverisë për mbështetjen e projektit multietnik për komunën e Novobërdës/Novo brdo

- (Projekti multietnik është miratuar me 49 vota për dhe një votë kundër.)
- Informatë nga grupi parlamentar i AAK-së lidhur me zëvendësimin e anëtarëve të saj në komisionet parlamentare
- Informatë lidhur me shpërbërjen e grupit parlamentar “Zajedno” (Shiko më poshtë pjesën e titulluar “Grupi parlamentar Zajedno pushon së ekzistuari”.)

Seancën plenare të mbajtur më 12 qershor e kryesuan anëtarët e Kryesisë së Kuvendit z. Xhavit Haliti (PDK) dhe z. Sabri Hamiti (LDK).

- Pesëdhjetë e katër³ deputetë ishin të pranishëm në seancën plenare më 12 qershor.
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare të mbajtur më 12 qershor:
 - Shqyrtimi i raportit financiar i Buxhetit të Konsoliduar për periudhën 1 janar – 31 dhjetor 2009 (Raporti financiar është miratuar me 44 vota për dhe 22 vota kundër.)

Seancën solemne plenare të mbajtur më 15 qershor e kryesoi Kryetari i Kuvendit Jakup Krasniqi (PDK) dhe anëtari i Kryesisë z. Xhavit Haliti (PDK).

- Gjashtëdhjetë e tetë deputetë ishin të pranishëm në seancën plenare më 15 qershor.
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare të mbajtur më 15 qershor:
 - Fjala e z. Maarti Ahtisaari në Kuvendin e Kosovës

Seancën plenare të mbajtur më 23 qershor e kryesoi Kryetari i Kuvendit Jakup Krasniqi (PDK) dhe anëtari i Kryesisë z. Ibrahim Gashi (AKR).

- Nëntëdhjetë e shtatë deputetë ishin të pranishëm në seancën plenare më 23 qershor.
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare të mbajtur më 23 qershor:
 - Debat lidhur me incidentin në dhomën e dëshmive të Policisë së Kosovës (Ministri i brendshëm Zenun Pajaziti paraqiti informatën pasuar nga debati i gjerë parlamentar të cilin e përmylli ministri Pajaziti.)

Seancën plenare të mbajtur më 25 qershor e kryesoi Kryetari i Kuvendit Jakup Krasniqi (PDK) dhe anëtari i Kryesisë z. Eqrem kryeziu (LDK).

- Gjashtëdhjetë e gjashtë deputetë ishin të pranishëm në seancën plenare më 25 qershor.
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare të mbajtur më 25 qershor:
 - Pyetjet për Qeverinë për përgjigje me gojë
 - Shqyrtimi i parë i projektligjit për ndryshimin e ligjit Nr. 2003/3 për pyjet e Kosovës (Projektligji është miratuar në parim me 56 vota për dhe tri vota kundër.)
 - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për ndryshimin e ligjit Nr. 2004/5 për tregtinë me naftë dhe produkte të naftës në Kosovë (Projektligji është miratuar me 54 vota për dhe pa vota kundër.)
 - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për lizingun financiar (Projektligji është miratuar me 58 vota për dhe pa vota kundër.)
 - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për themelimin e departamentit të mjekësisë ligjore (Projektligji është miratuar me 55 vota për dhe pa vota kundër.)
 - Shqyrtimi i projektligjit për të drejtat sendore (Projektligji është miratuar me 52 vota për dhe pesë vota kundër.)
 - Shqyrtimi i raportit të komisionit për ndihmë juridike (Raporti është miratuar me 57 vota për dhe katër vota kundër.)

³ Numri i deputetëve të pranishëm në sallën plenare u ngrit dhe kuorumi u arrit gjatë seancës plenare.

- Shqyrtimi i raportit për vitin 2008 i Komisionit të Pavarur të Mediave (Raporti është miratuar me 43 vota për dhe 13 vota kundër.)
- Shqyrtimi i propozim-vendimit të qeverisë lidhur me emërimin e zëvendës drejtorit të sekretariatit ekzekutiv të agjensisë së pronës dhe dy anëtarëve të bordit të agjensisë së pronës. (Emërimet janë refuzuar, respektivisht, me 23 vota për dhe 35 vota kundër, dhe me 11 vota për dhe 42 vota kundër⁴.)
- Shqyrtimi i dytë i projektligjit për partneritetin publiko-privat dhe koncesionet në ofrimin e infrastrukturës dhe shërbimeve dhe procedurës për dhënien e tyre (Projektligji është miratuar me 52 vota për dhe shtatë vota kundër.)

3. Punimet dhe praktikat parlamentare në seancat e Kuvendit

Procesi legjislativ

- Projektligji për produktet biocide është miratuar tre muaj e gjysmë pas miratimit të tij në parim në seancën plenare të mbajtur më 12 mars 2009. Projektligji për bujqësinë dhe zhvillimin rural është miratuar më shumë se shtatë muaj pas miratimit në parim në seancën plenare të mbajtur më 6-7 nëntor 2008. Projektligji për ndryshimin e ligjit për tregtinë me naftë dhe produkte të naftës në Kosovë është miratuar më shumë se tre muaj pas miratimit në parim në seancën plenare të mbajtur më 12 mars 2009. Projektligji për lizingun financiar është miratuar më shumë se shtatë muaj pas miratimit në parim në seancën plenare të mbajtur më 6-7 nëntor 2008. Projektligji për themelimin e departamentit të mjekësisë ligjore është miratuar më shumë se tre muaj pas miratimit në parim në seancën plenare të mbajtur më 12 mars 2009. Projektligji për të drejtën sendore është miratuar gati pesë vite⁵ pas miratimit të tij në parim në seancën plenare të mbajtur më 8 korrik 2004. Projektligji për partneritetin publiko-privat dhe koncesionet në ofrimin e infrastrukturës dhe shërbimeve dhe procedurës për dhënien e tyre është miratuar më shumë se njëmbëdhjetë muaj pas miratimit në parim në seancën plenare të mbajtur më 27 korrik 2008.

Sipas rregullës 35.6 “Në rastet kur një komision është caktuar ta shqyrtojë projektligjin, atëherë ai i raporton rekomandimet e veta në Kuvend, por jo më vonë se dy (2) muaj nga shqyrtimi i parë i projektligjit, përveç rasteve kur është miratuar një kohëzgjatje shtesë nga Kuvendi” Të gjitha ligjet e lartpërmendura janë miratuar nga Kuvendi mjaftë gjatë pas afatit të paraparë me rregullën 35.6 dhe komisionet përgjegjëse funksionale nuk kanë kërkuar nga Kuvendi zgjatjen e afatit, gjë që nuk është në pajtim me rregullën 35.6. Andaj, sërish rekomandohet që komisionet e Kuvendit t’i shqyrtojnë projektligjet brenda kohës së paraparë me rregullën 35.6 në mënyrë që ta rrisin efektivitetin e procesit legjislativ dhe t’i përmbahen rregullores së punës.

Shpërndarja e projektligjeve

- Projektligji për standardizimin është shpërndarë më 22 prill. Projektligji për fuqizimin dhe pjesëmarrjen e rinisë është shpërndarë më 25 prill. Andaj, projektligjet janë shpërndarë, respektivisht, 15 dhe 13 ditë pune para shqyrtimit të tyre të parë në seancën plenare të mbajtur më 14 maj 2009. Projektligji për tatimin mbi vlerën e shtuar është shpërndarë më 27 prill. Projektligji është shpërndarë të njëjtën ditë kur është bërë shqyrtimi i parë i tij më 27 maj. Projektligji për ndryshimin e ligjit Nr. 2003/3 për pyjet e Kosovës është shpërndarë më 19 maj. Projektligji është shpërndarë 26 ditë pune para shqyrtimit të tij të parë në seancën plenare të mbajtur më 25 qershor 2009. Projektligji për anëtarësimin e Kosovës në fondin monetar ndërkombëtar dhe grupin e bankës botërore është shpërndarë më 19 maj. Andaj, projektligji

⁴ Kuvendi ka mbajtur dy votime të veçanta. Një votim për emërimin e zëvendës drejtorit të sekretariatit ekzekutiv të agjensisë së pronës dhe një votim për emërimin e kandidatëve të propozuar për anëtarë të bordit të agjensisë së pronës.

⁵ Projektligji për të drejtat sendore është miratuar në shqyrtim të dytë në seancën plenare të mbajtur më 8-9 shtator 2004, gjatë mandatit të parë legjislativ, por nuk është shpallur nga PSSP-ja. Andaj, Kuvendi i Kosovës në mandatin aktual ka vendosur që ta shqyrtojë dhe miratojë këtë projektligj si dhe projektligjet tjera që nuk janë shpallur nga ana e PSSP-së.

është shpërndarë gjashtë ditë para shqyrtimit të tij të parë në seancën plenare të mbajtur më 28 maj 2009. Projektligji për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publik dhe projektligji për ndryshimin e ligjit Nr. 02/L-133 për parandalimin e konfliktit të interesit gjatë ushtrimit të funksionit publik janë shpërndarë më 20 maj. Andaj, projektligjet janë shpërndarë 17 ditë pune para shqyrtimit të tyre të parë në seancën plenare të mbajtur më 11 qershor 2009.

Rregulla 35.1 parasheh që shqyrtimi i parë i projektligjit duhet të bëhet jo më parë se dhjetë ditë pune dhe as më shumë se tri javë pune nga dita pas shpërndarjes së tij. Andaj, dy nga projektligjet e lartëpërmendura - projektligji për standardizimin dhe projektligji për fuqizimin dhe pjesëmarrjen e rinisë - janë shqyrtuar për herë të parë në pajtim me rregullën 35.1. Megjithëkëtë, pesë projektligjet e tjera - projektligji për tatimin mbi vlerën e shtuar, projektligji për ndryshimin e ligjit Nr. 2003/3 për pyjet e Kosovës, projektligji për anëtarësimin në fondin monetar ndërkombëtar dhe grupin e bankës botërore, projektligji për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publik, dhe projektligji për ndryshimin e ligjit Nr.02/L-133 për parandalimin e konfliktit të interesit gjatë ushtrimit të funksionit publik – nuk janë shqyrtuar për herë të parë në pajtim me rregullën 35.1. Projektligji për ndryshimin e ligjit Nr. 2003/3 për pyjet e Kosovës, projektligji për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publik dhe projektligji për ndryshimin e ligjit Nr.02/L-133 për parandalimin e konfliktit të interesit gjatë ushtrimit të funksionit publik janë shqyrtuar më shumë se tri javë pune pas shpërndarjes së tyre derisa shpërndarja e projektligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar dhe projektligjit për anëtarësimin në fondin monetar ndërkombëtar dhe grupin e bankës botërore, respektivisht, në ditën e shqyrtimit të parë, dhe gjashtë ditë pune para shqyrtimit të tij të parë, nuk u ka lejuar kohë të mjaftueshme deputetëve për t'i studiuar dhe vlerësuar ato.

Procesi i votimit

- Në seancën plenare të mbajtur më 14-15-22-27-28 maj, kur kryesuesi lajmëroi pikën përkatëse të rendit të ditës – shqyrtimi i dytë i projektligjit për produktet biocide – kryesuesi poashtu lajmëroi se në sallë ishin vetëm 59 deputetë të pranishëm dhe kërkoi nga zyrtarët e Kuvendit që t'i bien ziles për t'i ftuar deputetët të cilët ishin jashtë seancës plenare që të kthehen në sallë në mënyrë që votimi të fillojë. Kuorumi u arrit meqë disa deputetë u kthyen dhe kryesuesi vazhdoi me votimin e amandamenteve, megjithatë, pak pas fillimit të votimit, numri i deputetëve të pranishëm ra nën 61. Kryesuesi lajmëroi se nuk kishte pasur kuorum me rastin e votimit të amandamentit paraprak dhe tha se ai amandament nuk është miratuar, dhe kërkoi sërish nga deputetët që të kthehen në seancë. Megjithëkëtë, kur kryesuesi e kuptoi që kuorumi nuk do të mund të arrihej, kryesuesi e shtyu seancën plenare për ditën e nesërme. Më 15 maj, në fillim të vazhdimin të seancës plenare, kryesuesi lajmëroi se sërish, nuk kishte kuorum dhe meqë të gjitha pikat e rendit të ditës kërkonin votim, ai e shtyu seancën plenare përsëri.

Më 27 maj, në vazhdimin e seancës plenare të filluar më 14 maj, gjatë zhvillimit të debatit për themelimin e komisionit *ad hoc* për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të bordit të RTK-së, kryesuesi lajmëroi se numri i përgjithshëm i deputetëve kishte rënë nën gjysmë, andaj, debati mund të vazhdonte por votim nuk mund të mbahej. Kah përfundimi i debatit kryesuesi lajmëroi se numri i deputetëve kishte rënë në 39, më pak se një e treta, andaj ai e përfundoi seancën plenare, për ta vazhduar ditën e nesërme më 28 maj.

Në vazhdimin e seancës plenare më 28 maj, kur kryesuesi po përgatitej të fillonte me pikën e radhës së rendit të ditës – shqyrtimi i parë i projektligjit për anëtarësimin e Kosovës në fondin monetar ndërkombëtar dhe grupin e bankës botërore – ai kërkoi që të numërohen deputetët e pranishëm. Në sallë ishin të pranishëm vetëm 57 deputetë andaj kryesuesi e shtyu seancën plenare për ditën e nesërme në mënyrë që projektligji të miratohej në parim.

Vendimi i kryesuesit për ta shfuqizuar rezultatin e votimit të një amandamenti në seancën plenare më 14 maj ishte në pajtim me rregullën 31.3 të rregullores e cila parasheh që “vendimet

e Kuvendit konsiderohen të miratuara kur për to të ketë votuar shumica e deputetëve të pranishëm dhe që votojnë”.

Vendimi i kryesuesit që ta shtyjë seancën më 14 dhe 28 maj për shkak të mungesës së kuorumit për votim ishte i nevojshëm meqë të gjitha pikat e rendit të ditës kërkonin kuorum për votim të 61 deputetëve të pranishëm, dhe ishte e qartë se një kuorum i tillë nuk do të arrihej.

Më 27 maj, kryesuesi e shtyu seancën plenare pas konkludimit se numri i përgjithshëm i deputetëve të pranishëm kishte rënë nën një të tretën. Kjo është në pajtim me rregullën 31.2 të rregullores së punës e cila parasheh që “mbledhjet e Kuvendit ndërpriten nëse numri i deputetëve të pranishëm në sallë bie nën një të tretën e numrit të përgjithshëm”.

Kuvendi has vështirësi në menagjimin e seancave plenare

- Seanca plenare e 14-15-22-27-28 majit është ndërprerë dhe shtyrë disa herë. Kryesuesi më 14 maj e shtyu seancën plenare për ditën e nesërme 15 maj, meqë nuk kishte kuorum për votim. Vazhdimi i seancës plenare më 15 maj është shtyrë përsëri për datën 22 maj meqë kuorumi për votim nuk u arrit fare. Më 22 maj, në vazhdimin e seancës plenare, me propozim të deputetit Hajredin Hyseni (PDK) dhe i mbështetur nga grupet parlamentare të PDK-së, AAK-së dhe AKR-së, vazhdimi i seancës plenare të filluar më 14 maj u shty përsëri për datën 27 maj. Më 27 maj seanca u vazhdua dhe disa pika të rendit të ditës u kryen por, kur pika e fundit e rendit të ditës u lajmërua, u vërtetua se nuk ka kuorum meqë vetëm 39 deputetë ishin të pranishëm në sallë, andaj, kryesuesi i obliguar nga rregullorja, e shtyu vazhdimin e seancës plenare për datën 28 maj. Më 28 maj, Kuvendi, më në fund arriti ta përfundojë pikën e fundit të rendit të ditës dhe seancën plenare në tërësi të filluar më 14 maj.

Shtyerjet e seancës plenare të filluar më 14 maj, si rezultat i mungesës së kuorumit në tri raste dhe për shkak të një kërkesë nga një deputet, të mbështetur nga së paku tri grupe parlamentare, në një rast, tregon nevojën për planifikim dhe organizim më të mirë të rendit të ditës së seancave plenare dhe për më shumë kordinim dhe koncenzus në mes të grupeve parlamentare dhe Kryesisë. Është tejet e rekomandueshme që për t’iu shmangur situatave të ngjashme në të ardhmen, planifikimi i rendit të ditës të bëhet në bashkëpunim të ngushtë me qeverinë dhe shefat e grupeve parlamentare në mënyrë që të përcaktohet se cilat pika të rendit të ditës dhe të punës mund të procesohen dhe të përfundohen dhe poashtu të shmanget heqja apo shtimi i pikave në rend të ditës gjatë seancave plenare (përveç nëse janë urgjente), meqë një gjë e tillë ka shkakuar probleme në të kaluarën. Ndryshime të tilla në moment të fundit poashtu mund të çojnë në ngarkimin e rendeve të ardhshme të ditës, që për rezultat mund të prodhojnë probleme të panevojshme në menagjimin e seancave plenare.

Kuvendi vazhdon të ketë vështirësi në menagjimin e kohës për pyetjet parlamentare

- Në seancën plenare më 14-15-22-27-28 maj, vetëm njëmbëdhjetë nga 40 pyetje morën përgjigje, derisa gjashtë pyetje u shtyen për seancën e radhës sepse koha për pyetje parlamentare ka kaluar. Në seancën plenare të mbajtur më 28 maj vetëm gjashtë nga 41 pyetje kanë marrë përgjigje. Së paku njëmbëdhjetë pyetje janë tërhequr nga ana e deputetëve të opozitës sepse ata mendonin se menagjimi i kohës për pyetje parlamentare ishte i dobët, derisa pyetjet e mbetura u shtyen për seancën e radhës sepse koha për pyetje parlamentar kishte përfunduar. Në seancën plenare të mbajtur më 11-18 qershor, vetëm nëntë nga 33 pyetje kanë marrë përgjigje. Në seancë plenare të mbajtur më 25 qershor, shtatë nga 25 pyetje kanë marrë përgjigje. Kryetari i Kuvendit apo kryesuesi ka lajmëruar se pyetjet që nuk kanë marrë përgjigje gjatë dy seancave plenare, do të publikohen në Buletinin e Kuvendit.

Koha për pyetjet parlamentare gjatë periudhës raportuese është bërë në pajtim me rregullën 26 mbi “pyetjet për Qeverinë për përgjigje gojore”, e cila parasheh që rendi i ditës i secilës seancë plenare të përfshijë një periudhë deri në 50 minuta për pyetjet e deputetëve për Qeverinë, ku një minutë zgjat pyetja, tre minuta përgjigja e ministrit, një minutë pyetja shtesë, dhe dy minuta për përgjigjen në pyetjen shtesë.

Është vërejtur më herët si dhe gjatë periudhës raportuese në fjalë, se, jo të gjitha pyetjet parlamentare mund të procedohen gjatë kohës prej 50 minutash për shkak të numrit të madh të pyetjeve të parashtruara nga deputetët. OSBE-ja i ka rekomanduar Kuvendit që ta zgjasë kohën për pyetje parlamentare dhe/ose ta kufizojë numrin e pyetjeve për deputet në mënyrë që t'u ipet rasti të gjithë deputetëve të cilët kanë parashtruar pyetje, që t'i lexojnë ato në kohën e paraparë dhe të marrin përgjigje. Vlen të përmendet se Komisioni për Rregulloren e Kuvendit ka paraparë dispozita të reja në projektregulloren e re të Kuvendit, sipas të cilave koha për pyetje parlamentare zgjat deri në 60 minuta dhe se deputeti i Kuvendit mund të bëjë vetëm dy pyetje në një seancë plenare. Dispozitat e reja kanë për qëllim që kohën për pyetje parlamentare ta bëjnë më të efektshme duke iu mundësuar deputetëve që parashtrojnë pyetje, mundësi më të mirë që të marrin përgjigje në kohë të duhur. Megjithatë, edhe pas një viti e gjysmë nga fillimi i mandatit aktual, rregullorja e re e punës ende nuk është miratuar nga Kuvendi. Është tejet e rekomandueshme për Kuvendin që ta miratojë rregulloren e re të punës në mënyrë që, mes tjerash, ta lehtësojë dhe ta mbajë në mënyrë më të efektshme kohën për pyetje parlamentare.

Kuvendi zgjedh Avokatin e Popullit

- Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 2 qershor, ka radhitur zgjedhjen e Avokatit të Popullit për seancën plenare të 4 qershorit. Në seancën plenare më 4 qershor, Kryetari i Kuvendit tha se komisioni për legjislacion dhe gjyqësi ka shqyrtuar raportin e panelit për përzgjedhjen e kandidatëve për Avokat të Popullit dhe ftoi kryesuesin e komisionit për legjislacion dhe gjyqësi z. Bahri Hyseni (PDK) që ta informojë seancën plenare lidhur me procesin e rekrutimit dhe procedurën e votimit. Z. Hyseni e informoi seancën se Kryesia më 31 mars ka autorizuar dy komisione parlamentare – komisionin për të drejtat e njeriut, barazi gjinore dhe persona të zhdukur dhe komisionin për legjislacion dhe gjyqësi – që ta formojnë një panel rekrutues për përzgjedhjen dhe intervistimin e kandidatëve për Avokat të Popullit. Paneli është formuar, dhe kryesues i tij është caktuar deputeti i opozitës z. Ibrahim Makolli (AKR). Komisioni për legjislacion dhe gjyqësi më 18 maj ka shqyrtuar rekomandimet e panelit rekrutues dhe ka konkluduar se procedura për përzgjedhjen dhe intervistimin e kandidatëve ishte korrekte dhe bazuar në rekomandimin e panelit, komisioni, seancës plenare i ka propozuar tre kandidatë – z. Sami Kurteshi, z. Besnik Osmani dhe z. Veton Vula – për shqyrtim. Z. Hyseni më tutje tha se gjatë mandatit aktual në tri raste të ndryshme ka rekomanduar kandidatë për Avokat të Popullit⁶ dhe shtoi se meqë institucioni i Avokatit të Popullit është i rëndësishëm për popullin e Kosovës sepse do t'i "mbrojë të drejtat dhe liritë e tyre nëse do të shkelen nga vendime të qeverisë" bëri thirrje deputetëve të Kuvendit që të votojnë për njërin kandidat në mënyrë që të përmbillet zgjedhja e Avokatit të Popullit. Kryetari i Kuvendit më pas e informoi seancën se votimi do të jetë i fshehtë dhe se deputetët mund të votojnë vetëm për një kandidat. Kryetari i Kuvendit më pas i ftoi të gjitha grupet parlamentare që t'i propozojnë deputetët për komision votues për ta udhëhequr dhe monitoruar procedurën votuese. Të gjitha grupet parlamentare propozuan deputetin përkatës dhe Kryetari i Kuvendit filloi t'i thërras secilin deputetët me renditje alfabetike për të votuar. Pas përfundimit të votimit komisioni i votimit numëroi fletëvotimet. Kryetari i Kuvendit e ftoi kryesuesin e komisionit votues që ta prezantoj rezultatin e votimit. Z. Enis Kervan (7+/KDTP) e paraqiti rezultatin e votimit. Ai lajmëroi se 107 deputetë kanë votuar dhe se z. Sami Kurteshi ka marrë 65 vota, z. Besnik Osmani 27 dhe z. Veton Vula 10, derisa pesë fletëvotime ishin të pavlefshme. Andaj, kryesuesi i komisionit votues përfundoi se bazuar në rezultatin e raundit të parë të votimit, z. Sami Kurteshi është zgjedhur Avokat i Popullit për një mandat pesë vjeçar pa të drejtë ri zgjedhjeje. Kryetari i Kuvendit, pas lajmërimit

⁶ Kuvendi i Kosovës gjatë këtij mandati por edhe në mandatin e kaluar ka dështuar në katër raste që ta zgjedh Avokatin e Popullit që nga shpallja e rregullores së UNMIK-ut 2006/6 në shkurt të vitit 2006, me të cilën i janë transferuar përgjegjësitë për operimin e institucionit të Avokatit të Popullit institucioneve lokale. Pë më shumë detaje shiko raportet e OSBE-së 01/2009, 05/2008 dhe 04/2008.

të rezultatit të votimit, ftoi Avokatin e Popullit të sapozgjedhur z. Kurteshi, që të bëjë betimin solemn para Kuvendit. Z. Kurteshi bëri betimin dhe kështu seanca plenare mori fund.

Kreu 6.2 i rregullores së UNMIK-ut 2006/6 mbi institucionin e Avokatit të Popullit parasheh që Avokati i Popullit zgjedhet nga Kuvendi i Kosovës me procedurë të hapur dhe transparente kur për të të kenë votuar shumica e deputetëve të Kuvendit të Kosovës, që domethënë duhet të ketë mbështetjen e së paku 61 deputetëve të Kuvendit. Andaj, zgjedhja e Avokatit të Popullit nga Kuvendi i Kosovës është bërë në pajtim me rregulloren e UNMIK-ut 2006/6 si dhe rregulloren e Kuvendit të Kosovës për zgjedhjen e Avokatit të Popullit. Zgjedhja e Avokatit të Popullit është një hap i rëndësishëm drejtë krijimit të qëndrueshëm të institucioneve demokratike në Kosovë, posaçërisht në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

Kuvendi miraton gjashtë gjyqtarë të gjykatës kushtetuese

- Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 13 maj, ka shqyrtuar propozimin e qeverisë për miratimin e gjashtë gjyqtarëve të gjykatës kushtetuese. Në këtë mbledhje Kryetari i Kuvendit ka thënë se as kushtetuta e as ligji për gjykatën kushtetuese nuk përmbajnë metodë të posaçme të votimit, andaj, ai propozoi një metodë të posaçme votimi. Ky propozim parasheh që votimi të jetë i hapur dhe elektronik. Kryesuesi fton grupet parlamentare që secila të propozoj një listë me katër kandidatë të zgjedhur nga ta. Më pas kryesuesi hedh këto lista në votim të hapur. Nëse njëra nga listat merr votën e dy të tretave të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë, atëherë kjo listë, respektivisht, këta katër kandidatë zgjedhen gjyqtarë të gjykatës kushtetuese. Nëse asnjëra nga listat nuk merr mbështetjen e dy të tretave të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë, atëherë, dy listat që kanë marrë numrin më të madh të votave vazhdojnë në raundin e dytë të votimit. Kryesuesi më pas i hedh këto dy lista në votim të hapur. Nëse njëra nga listat merr votat e dy të tretave të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë, lista konsiderohet e miratuar, përndryshe lista e cila ka marrë numrin më të madh të votave në raundin e dytë vazhdon në raundin e tretë dhe të fundit të votimit. Kryesuesi e hedh në votim të hapur listën e mbetur. Nëse kjo listë merr dy të tretat e votave të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë, kandidatët në këtë listë konsiderohen të miratuar. Nëse lista e mbetur nuk merr mbështetjen e dy të tretave të deputetëve, procesi i votimit përfundon. Në Kryesi pati debat ku kryesisht u shprehën shqetësime lidhur me propozimin por në fund u pajtua që të përdoret kjo mënyrë e propozuar e votimit.

Në seancën plenare të 15 majit, Kryetari i Kuvendit e informoi seancën plenare se katër nga gjashtë gjyqtarët do të miratohen me mbështetjen e dy të tretave të të gjithë deputetëve të pranishëm dhe që votojnë. Dy gjyqtarë nga radhët e komunitetit jo shqiptar do të miratohen me mbështetjen e dy të tretave të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë pasi këta kandidatë fillimisht të kenë marrë mbështetjen e shumicës së deputetëve nga komuniteti jo shqiptar. Kryetari i Kuvendit më pas ftoi grupet parlamentare që t'i propozojnë listat e tyre përkatëse. Z. Ramë Buja (PDK) në emër të grupit parlamentar të PDK-së propozoi listën me katër kandidatë: Z. Enver Hasani, znj. Gjyljeta Mushkolaj, z. Kadri Kryeziu dhe z. Iliriana Ismaili. Z. Lutfi Haziri (LDK) në emër të grupit parlamentar të LDK-së e mbështeti listën e propozuar nga grupi parlamentar i PDK-së. Znj. Ritë Hajzeraj (AKR) në emër të grupit parlamentar të AKR-së e kritikoi mënyrën e votimit por, megjithatë, propozoi një listë me kandidatë: Z. Riza Smaka, z. Enver Hasani, znj. Gjyljeta Mushkolaj dhe z. Fejzullah Berisha. Z. Ardian Gjini (AAK) në emër të grupit parlamentar të AAK-së e mbështeti listën e propozuar nga grupi parlamentar i PDK-së. Z. Lulzim Zeneli (LDD) në emër të grupit parlamentar të LDD-së propozoi listën me katër kandidatë: Z. Halit Muharremi, z. Enver Hasani, znj. Iliriana Ismaili dhe znj. Gjyljeta Mushkolaj. Znj. Muferra Sinik (7+/KDTP) në emër të grupit parlamentar 7+ e mbështeti listën e propozuar nga grupi parlamentar i PDK-së dhe propozoi kandidatin e tyre z. Altay Suroy. Z. Bojan Stojanović (SLS) në emër të grupit parlamentar SLS poashtu mbështeti listën e propozuar nga grupi parlamentar i PDK-së dhe propozoi kandidatin e tyre z. Ivan Čukalović. Z. Slaviša Petković (Zajedno) në emër të grupit parlamentar Zajedno e mbështeti listën e propozuar nga

grupi parlamentar i PDK-së si dhe të dy kandidatët e propozuar nga komunitetet jo shqiptare të propozuara nga grupet parlamentare 7+ dhe SLS.

Pas paraqitjes së propozimeve Kryetari i Kuvendit e hedhi në votim kandidatin e propozuar nga grupi parlamentar SLS dhe shpjegoi se në këtë moment votojnë vetëm deputetët jo shqiptarë. Z. Ivan Čukalović mori mbështetjen e të gjithë – 22 - deputetëve jo shqiptarë të pranishëm dhe që votuan. Kryetari i Kuvendit më pas e hedhi në votim kandidatin e propozuar nga grupi parlamentar 7+. Z. Altay Suroy mori mbështetjen e 17 deputetëve të komunitetit jo shqiptar të pranishëm dhe që kanë votuar ndërsa pesë vota ishin kundër. Kryetari i Kuvendi lajmëroi se të dy kandidatët kanë marrë mbështetjen e deputetëve jo shqiptarë të pranishëm dhe që votojnë andaj i hodhi dy kandidatët në votim për t'u votuar nga të gjithë deputetët e pranishëm dhe që votojnë. Dy kandidatët morën 71 vota për, tri vota kundër derisa pesë deputetë abstenuan.

Kryetari i Kuvendit vazhdoi duke hedhur në votim listat e propozuara nga grupet parlamentare shqiptare. Lista e propozuar nga grupi parlamentar i PDK-së dhe i mbështetur nga grupet parlamentare të LDK-së dhe AAK-së u hodh e para në votim. Kjo listë mori 76 vota për, gjashtë vota kundër dhe dy abstenime. Kryetari i Kuvendit lajmëroi se lista ka marrë mbështetjen e dy të tretave të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë ashtu siç kërkohet dhe se kështu Kuvendi ka miratuar gjashtë gjyqtarët e gjykatës kushtetuese të cilët do t'i dërgohen Kryetarit të Kosovës për dekretim. Me miratimin e gjashtë gjyqtarëve seanca plenare mori fund.

Dy dokumentat që bëjnë fjalë për gjykatën kushtetuese dhe miratimin e gjyqtarëve të gjykatës kushtetuese janë kushtetuta dhe ligji për gjykatën kushtetuese. Megjithatë, në kushtetutë vetëm shkurtimisht përmendet mbështetja e nevojshme prej dy të tretave të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë në mënyrë që gjyqtarët të miratohen por nuk parasheh mënyrë specifike të votimit, derisa ligji për gjykatën kushtetuese nuk përmban mënyrën e votimit as mbështetjen e nevojshme, por vetëm procedurën për përzgjedhjen e kandidatëve. Andaj, në mungesë të një metode specifike të votimit Kryetari i Kuvendit në mbledhjen e Kryesisë më 13 maj ka propozuar mënyrë specifike të votimit siç është përshkruar në paragrafet më lartë. Propozimi, edhe pse i debatuar gjërësisht, është mbështetur nga shumica e anëtarëve të Kryesisë dhe shefave të grupeve parlamentare. Do të ishte e këshillueshme për Kryetarin e Kuvendit që ta hudhte në votim propozimin në seancë plenare në mënyrë që metoda e votimit të mbështetej nga deputetët duke e bërë kështu më demokratike dhe më përfaqësuese. Votimi i gjyqtarëve kushtetuese është bërë në pajtim me mënyrën e propozuar të votimit.

Kuvendi emëron zëvendës kryeministrin Hajredin Kuçi kryesues të komisionit *ad hoc* për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të bordit të Radio Televizionit të Kosovës

- Në seancën plenare të mbajtur më 30 prill, pika e rendit të ditës – themelimi i komisionit *ad hoc* për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të bordit të Radio Televizionit të Kosovës – është shtyrë për seancën plenare të radhës me kërkesë të grupit parlamentar të PDK-së, sepse grupi dëshironte ta ndryshojë anëtarin fillestar që e pati propozuar për komisionin *ad hoc*. Më 29 prill, grupi parlamentar i PDK-së i ka dërguar letër Kryesisë duke i bërë me dije se zëvendës kryeministri Hajredin Kuçi (PDK) propozohet si kryesues i komisionit *ad hoc* në vend të z. Hajdin Abazi. Themelimi i komisionit *ad hoc* u radhit për seancën plenare të 14-15-22-27-28 majit. Kur kryesuesi e lajmëroi pikën e rendit të ditës në fjalë, ai e informoi seancën plenare se të gjitha partitë politike të përfaqësuara në Kuvend i kanë propozuar kandidatët e tyre për në komisionin *ad hoc* dhe se ishte e panevojshme që grupet parlamentare të deklarohen mëtutje për këtë çështje dhe vazhdoi për ta hedhur listën e kandidatëve në votim. Megjithatë, meqë kishte reagime nga grupet parlamentare opozitare ai i dha fjalën përfaqësuesve të grupeve. Z. Bahri Hyseni (PDK) në emër të grupit parlamentar të PDK-së e mbështeti listën dhe i ftoi edhe deputetët tjerë që ta bëjnë këtë. Z. Lutfi Haziri (LDK) në emër të grupit parlamentar të LDK-së tha se dy çështje duhet të shikohen me kujdes: prania e anëtarëve të qeverisë në komisionin *ad hoc* dhe përfaqësimi i partive politike të pacertifikuara të cilat kanë hyrë në Kuvend vetëm për faktin se ishin pjesë e koalicionit me parti më të mëdha dhe vazhdoi duke thënë se shumica e partive ja kanë dalë të hyjnë në Kuvend vetëm në sajë të koalicionit me partitë më të mëdha

politike. Sidoqoftë, ai e mbështeti listën e kandidatëve. Z. Esat Brajshori (AKR) në emër të grupit parlamentar të AKR-së tha se ishte kundër kandidatit të ri të propozuar nga grupi parlamentar i PDK-së meqë ai mban postin e zëvendës kryeministrit andaj nuk mund të caktohet në ndonjë komision *ad hoc* të Kuvendit, sepse kjo ndalohej me rregullën 42 të rregullores së Kuvendit. Ai më tutje ftoi grupin parlamentar të PDK-së që ta rishqyrtojë propozimin për kandidatin e tyre dhe konkludoi se nëse propozimi i tij nuk mirret parasysht, grupi parlamentar i AKR-së nuk do ta votoj listën e kandidatëve. Ai poashtu e mbështeti z. Lutfi Haziri lidhur me përfshirjen e kandidatëve të të gjitha partive politike në listë. Znj. Gjylnaze Sylja (AAK) në emër të grupit parlamentar të AAK-së i mbështeti përfaqësuesit e LDK-së dhe të AKR-së dhe shtoi se z. Kuçi është jo vetëm anëtar i lartë i qeverisë por edhe deputet i Kuvendit dhe profesor duke aluduar se ai tashmë është i përfshirë në konflikt interesi dhe se Kuvendi nuk duhet ta lejojë atë që të emërohet kryesues i komisionit *ad hoc*. Znj. Besa Gaxherri (LDD) tha se është e dëshpëruar në grupin parlamentar të PDK-së dhe se LDD-ja nuk do ta votoj listën me këta kandidatë sepse paraqet shkelje të rregullores së Kuvendit. Z. Bahri Hyseni (PDK) duke mbrojtur emërimin e z. Kuçi tha se Kuvendi nuk po e themelon komisionin bazuar në rregulloren e punës por duke u bazuar në ligjin Nr. 02/L-47 për RTK-në. Kryesuesi i seancës tha se çështja e përfshirjes së kandidatëve të të gjitha partive politike, është debatuar në Kryesi dhe se është vendosur që të veprohet në pajtim me ligjin për RTK-në, i cili kërkon që të gjitha partitë politike të përfaqësuara në Kuvend të kenë nga një anëtar në komisionin *ad hoc*. Në këtë moment, kur kryesuesi po përgatitej për ta hedhur listën në votim, të gjithë deputetët e grupit parlamentar të AAK-së dhe dhe shumica e deputetëve të grupit parlamentar të LDD-së e braktisën sallën plenare duke e lënë seancën plenare pa kuorum për votim. Kryesuesi tha se nuk mund të mbahet votimi meqë numri i deputetëve ka rënë nën gjysmë, por theksoi se diskutimet mund të vazhdojnë meqë numri i deputetëve (pak më shumë se një e treta) e lejon këtë gjë dhe se disa deputetë kishin kërkuar fjalën. Por, në këtë pikë, deputetët filluan ta lëshojnë sallën plenare, siç duket për shkak se ishte e qartë se votimit nuk mund të mbahej, dhe numri i deputetëve të pranishëm ra nën një të tretën, ku kryesuesi e mbylli debatin lidhje me pikën e ditës në fjalë dhe e shtyu votimin për datën 28 maj.

Në vazhdimin e seancës plenare më 28 maj, kryesuesi z. Xhavit Haliti (PDK) deklaroi se debati për këtë pikë ka përfunduar ditën paraprake dhe se vetëm votimi ka mbetur për t'u përfunduar. Sërish, partitë opozitare reagues negativisht dhe kryesuesi kundërshtoi duke thënë se debati ka përfunduar dhe secila palë ka të drejtën të propozojë kandidatin e saj në pajtim me ligjin për RTK-në si dhe çdo parti politike e përfaqësuar në Kuvend ka të drejtë ta ketë anëtarin e saj në komisionin *ad hoc*. Kryesuesi, edhe përkundër kundërshtimit të vazhdueshëm nga opozita, e hodhi listën me kandidatë në votim e cila u miratuar me 56 vota për, 28 vota kundër dhe pesë abstenime, duke i mundësuar kështu zëvendës kryeministrit Hajredin Kuçi (PDK) të emërohet kryesues i komisionit *ad hoc* për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të bordit të RTK-së.

Rregulla 42.1 e rregullores së punës parasheh që "ministri i Qeverisë nuk mund të jetë anëtar i një komisioni". Për më tepër, rregulla 50.1 parasheh që "Kuvendi mund ta formojë një komision ad hoc me tërë autoritetin e komisionit funksional... Nëse Kuvendi merr vendim për themelimin e komisionit ad hoc, në vendim duhet të përfshihet edhe përbërja në pajtim me rregullën 42". Andaj, emërimi i zëvendës kryeministrit Hajredin Kuçi kryesues i komisionit ad hoc përbën shkelje të rregullores së punës. Deklarata e z. Bahri Hyseni (PDK) se themelimi i komisionit ad hoc bazohet në ligjin për RTK-në dhe jo në rregulloren e punës, injoron faktin se komisioni ad hoc është trup i Kuvendit dhe se përbërja e tij duhet të jetë në pajtim me rregulloren e punës së Kuvendit.

Misioni i OSBE-së në Kosovë, më 29 maj i ka dërguar letër Kryetarit të Kuvendit z. Jakup Krasniqi, ku është shprehur shqetësimi lidhur me emërimin e z. Kuçi si kryesues të komisionit ad hoc. Në letër është thënë se "Misioni i OSBE-së në Kosovë është i shqetësuar se emërimi i z. Kuçi në pozitën e kryesuesit të komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të bordit të drejtorëve të RTK-së mund të ketë ndikim në pavarësinë e transmetuesit publik, RTK, dhe se kjo do të pengojë procesin e përzgjedhjes së bordit të drejtorëve të RTK-së dhe

amandamentimin e ligjit për RTK-në. Andaj, Misioni ju inkurajon që të veproni në pajtim me rregulloren e punës së Kuvendit dhe ta rishqyrtoni emërimin e z. Kuçi në komisionin ad hoc për përzgjedhjen e bordit të drejtorëve të RTK-së”. Megjithëkëtë, nuk është ndërmarrë asnjë hap nga ana e Kryetarit të Kuvendit për të siguruar pajtueshmërinë me rregulloren e punës në këtë çështje.

Grupi parlamentar “zajedno” pushon së ekzistuari

- Më 3 qershor, deputeti z. Dragiša Mirić (SKSM) i ka dërguar letër Kryetarit të Kuvendit duke e njoftuar atë me vendimin për ta lëshuar grupin parlamentar “Zajedno”. Z. Mirić ka deklaruar se e ka marrë këtë vendim meqë marrëveshja për themelimin e grupit parlamentar nuk po respektohet dhe poashtu sepse grupi nuk po funksionon në pajtim me interesat e partnerëve të koalicionit⁷. Kryesia, në mbledhjen e mbajtur më 2 qershor e ka shqyrtuar letrën dhe ka konkluduar se me largimin e z. Mirić, grupi parlamentar ka mbetur me vetëm pesë deputetë dhe se nuk përbën grup parlamentar sipas rregullores së punës së Kuvendit. Kryetari i Kuvendit në seancën plenare të mbajtur më 4 qershor, ka informuar seancën plenare se grupi parlamentar “Zajedno” i formuar së fundmi ka pushuar së ekzistuari meqë një nga anëtarët e tij e ka braktisur grupin.

Sipas rregullës 11.1 (kreu IV i rregullores së punës), gjashtë apo më shumë deputetë të Kuvendit mund të formojnë grup parlamentar në funksion të një qëllimi politik të përbashkët dhe se emri i kryetarit dhe i anëtarëve të grupit parlamentar i komunikohen me shkrim Kryesisë së Kuvendit. Vendimi i z. Mirić për ta braktisur grupin parlamentar duke e lënë atë me vetëm pesë deputetë, automatikisht ka çuar në shpërbërjen e grupit parlamentar “Zajedno”.

4. Qasja

- Gjatë periudhës raportuese, Misioni i OSBE-së në Kosovë ka pasur qasje në seancat plenare, në mbledhjet e Kryesisë dhe në mbledhjet e komisioneve, në shqyrtim. Misioni i OSBE-së në Kosovë gjithashtu ka pranuar kopjet e dokumentave të shqyrtuara nga Kuvendi si dhe transkriptin e seancave të kaluara.

5. Transparenca

- Gjatë periudhës raportuese Kuvendi ka publikuar në web faqen e vet rezultatet elektronike të vendimeve të marra në seanca plenare gjatë periudhës raportuese. Publikimi i rezultateve të votimit elektronik është hap i rëndësishëm drejt rritjes së transparencës së Kuvendit, posaçërisht përgjegjësisë së deputetëve para votuesve të tyre.
- Radio Televizioni i Kosovës ka siguruar transmetimin e drejtpërdrejtë të seancave plenare në fjalë. Publikut dhe monitoruesve institucional iu është mundësuar hyrja në seancat plenare. Kuvendi ka ueb-faqen (www.assembly-kosova.org) që përmban detaje biografike të deputetëve të Kuvendit, informacione për strukturën dhe funksionimin e Kuvendit, procesverbale dhe transkripte nga seancat plenare të Kuvendit dhe mbledhjeve të komisioneve, kopje të ligjeve dhe rezolutave të miratuara nga Kuvendi, si dhe informacione të tjera.

FUND.

⁷ Sipas të gjitha gjasave, z. Mirić i është referuar partnerëve të koalicionit që e përbëjnë grupin parlamentar “Zajedno” dhe jo partnerët e koalicionit në qeveri.